

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit B.(A.)K. me vendbanim në fshatin B., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.2929/2017 të dt.26.09.2018, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të pandehurit B.K., pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më datën 07.12.2018, gjykata të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **B.K.**, nga babai A., dhe nënës S., e vajzërisë B., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim në fshatin B., Komuna e P., nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i fejuar, i gjendjes së mesme ekonomiko-sociale, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Sepse më datë 04.05.2017, rreth orës 16:47 deri në 17:00, i pandehuri B.K., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete apo për personin tjetër, nga shtëpia e tij në fshatin B., ka vjedhur gjësendet si paisje teknike: një gjenerator të tipit “Herkules” modeli HSA-36009, 51 kg, me nr. 0115-02, ngjyrë e kuqe, në vlerë prej 1800 (njëmijëtetëqind) euro, si dhe një Llaptop të tipit “Toshiba” ngjyrë e zezë, në vlerë prej 800 (tetëqind) euro, me ç’rast të dëmtuarës S.K. i ka shkaktuar dëm material,-

Gjatë muajit prill 2018, i pandehuri B.K., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete apo për personin tjetër, nga shtëpia e tij në fshatin B., ka vjedhur gjësendet teknike si: një papuqe-shtypëse e dheut në vlerë prej 2320 (dymijëetreqindnjëzet) euro, edhe një Hillt në vlerë prej 750 (shtatëqindpesëdhjet) euro, një burmashinë “Aeg”, me ç’rast të dëmtuarës S.K. i ka shkaktuar dëm material,-

- Më këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41,42, 46, 49, 50, 51, 52 dhe 73 si dhe nenit 325 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të pandehurin **B.K.**, e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej **1 (një) viti**, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej **250 Euro (dyqindpesëdhjet)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë dënimin me gjobë brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë dënimi me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, të papaguara të dënimin do t’i llogaritet një ditë burgim.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shpenzimet paushallë gjyqësore në shumën prej **20 Euro (njëzetë)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të kompenzimit të viktimave të paguaj shumën prej **30 Euro (tridhjetë)** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara S.K. nga fshati B., Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.2929/2017 të dt.26.09.2018, ka akuzuar të pandehurin B.(A.)K. me vendbanim në fshatin B., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt.07.12.2018, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i pandehuri B.K.

I pandehuri B.K., në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas të gjitha pikave të aktakuzës si dhe ka theksuar se më vjen keq që kam kryer këtë vepër, kam qenë shumë i ri, sendet i kam marrë në shtëpinë time, të gjitha sendet janë kthyer përsëri në shtëpi, i kërkoj falje prindërve poashtu edhe gjykatës. Lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë sepse jam i papunë.

Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se e pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti është në pajtim me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës me të cilat është ngritur aktakuza për veprën penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së. Ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari,

gjatë shqyrtimit gjyqësor fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, dhe ndjen shumë keqardhje për rastin dhe për veprimet e tij për të cilët edhe i kërkoi falje gjykatës dhe të dëmtuarës, janë kthyer sendet e vjedhura në shtëpi, ka qenë i ri në moshë, premtimin se do të jetë më i kujdesshëm në të ardhmen dhe nuk do të kryejë veprë penale të njëjtë apo tjera, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penalo-juridike vlera e mbrojtur është pasuria. Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim, është marrë në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave është marrë në bazë të nenit 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për kompenzimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor në bazë të dispozitave të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
P.nr.590/2018 më dt.07.12.2018

Gjyqtari:
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.